



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës

Durrës 25.05.2026

Lënda: Kthim përgjigje

Bazuar në ligjin 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", I ndryshuar, në përgjigje të kërkesës suaj ju informojmë si mëposhtë vijon:

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit që ka të bëjë me projektin e “Rehabilitimi i infrastrukturës së rrjetit në zonën e Porto Romanos-Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit, Faza I”, Ju bëjmë me dije se dokumentacioni i kërkuar gjendet pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Sidoqoftë në përputhje me Ligjin Nr. 119/2014 “ Për të drejtën e informimit” i ndryshuar, Ju informojmë mbi vendimmarjet e Këshillit Bashkiak Durrës si dhe të Këshillit të Ministrave lidhur me projektin e “Rehabilitimi i infrastrukturës së rrjetit në zonën e Porto Romanos-Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit, Faza I” si më poshtë :

- Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 18, datë 31.03.2023 “Për miratimin e parimit të vlerës financiare të shpronësimit, për pasuritë pronë private që preken nga investimi publik me objekt “Rehabilitimi i infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto Romanos-Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit, Faza I”.
- Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 136, datë 27.07.2023 “Për miratimin për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.18, datë 31.03.2023 “Për miratimin e parimit të vlerës financiare të shpronësimit, për pasuritë pronë private që preken nga investimi publik me objekt “Rehabilitimi i infrastrukturës së rrjetit të kullimit në zonën e Porto Romanos-Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit, Faza I”.
- Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.157, datë 18.10.2023 “Për miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit për pasuritë pronë private që preken nga investimi public me objekt : “Rehabilitimi i infrastrukturës së

rrjetit në zonën e Porto Romanos-Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit, Faza I”.

- Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.117, datë 24.12.2024 “Për miratimin e disa ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.157, datë 18.10.2023 “Për miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit për pasuritë pronë private që preken nga investimi public me objekt : “Rehabilitimi i infrastrukturës së rrjetit në zonën e Porto Romanos-Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit, Faza I”, i ndryshuar.
- Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 156, datë 12.03.2025 “Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit “ “Rehabilitimi i infrastrukturës së rrjetit në zonën e Porto Romanos-Kënetë dhe sistemimin e rrjetit të ujërave të shiut në zonën urbane të qytetit të Durrësit, Faza e Parë ”.

Ndërsa lidhur me informacionin që ka të bëjë me vendimmarrjet e Këshillit Bashkiak mbi miratimin e listës së familjeve të dëmtuara nga përmytjet dhe dëmshtëpërblimet e dhëna, Ju informojmë sa më poshtë :

- Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.41, datë 31.03.2021 “Për akordimin e ndihmës financiare për familjet e dëmtuara të shkaktuara nga rreshjet e dendura në njësitë administrative Sukth, Katund i Ri si dhe Njësia Administrative nr.6, Bashkia Durrës.
- Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.54, datë 20.04.2021 “Miratimin e ndryshimit të pikës 2 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.41, datë 31.03.2021 “Për akordimin e ndihmës financiare për familjet e dëmtuara të shkaktuara nga rreshjet e dendura në njësitë administrative Sukth, Katund i Ri si dhe Njësia Administrative nr.6, Bashkia Durrës.
- Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.117, datë 27.10.2022 “Për miratimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për emergjencat civile, që i është alokuar Bashkisë Durrës për vitin 2022”.
- Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.147, datë 28.09.2023 “Për miratimin e ndihmës financiare me vlerë 32.950.500 lekë për familjet e dëmtuara si pasojë e përmytjes nga rreshjet e shiut të datës 19.03.2018”.
- Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.75, datë 23.12.2025 “Për miratimin e ndihmës financiare me vlerë totale 50.572.489 për likujdimin e plotë të disa familjeve dhe për likujdimin me këste të pjesës tjetër, të dëmtuara nga përmytjet e shkaktuara nga rreshjet intensive të shiut të datave 29.01.2025-30.01.2025.

Sqarojmë se informacioni i mësipërm për emergjencat civile ka të bëjë vetëm me ndihmën financiare që bashkia Durrës ka akorduar për familjet e dëmtuara nga përmytjet, por nëse i referoheni procedurave të ndjekura për përbalimin e fatkeqësisë natyrore të tërmetit të vitit

2019, mund të konsultoheni me vendimmarjet e Këshillit Bashkiak në faqen zyrtare të institucionit, seksioni – Vendime të Këshillit Bashkiak.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin,